

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA GLLOGOC**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-23-5133-5-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj

NUI

Adresa

Vendi

Kodi postar

Numri Telefonit

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj

Adresa elektronike

Data e parashtrimit të kërkesës

27.06.2023

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-i

Adresa elektronike t

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë : 26.05.2023

Data e planifikuar e hapjes së ofertave: 03.07.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 27 i LPP-së

Neni 28 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 71 i LPP-së

Neni 18.9 i RRUOPP-së

Neni 26.4 i RRUOPP-së.

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me dt. 23.05.2023 është bërë publikimi i njoftimit për kontratë për aktivitetin e prokurimit Ndertimi , zgjerimi dhe rikonstruimi i rrjetit të kanalizimit në Drenas - Projekt dy vjeçar.

Fillimisht ju rikujtojmë se për këtë aktivitet të prokurimit kemi bërë njoftim për OE me dt: 02.06.2023 se ky aktivitet i prokurimit është inicuar pa projekt.

Ju rikujtojmë se keni një vendim të OSHP me nr 727/22 ku ju thuhet qartë se ju si AK e keni të ndaluar të filloni me procedurën e prokurimit pa hartuar projekt ekzistues, sepse e keni obligim ligjor.

Duke kufizuar tej mase konkurrenca dhe mundësia është shumë e madhe e dëmtimit të buxhetit dhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik.

Ku me këtë po e bëni të pamundur ofertimin edhe për OE me përvojë të madhe në këtë fushëveprim.

Ju sqarojmë se ju keni inicuar këtë aktivitet të prokurimit, pa hartuar fillimisht një projekt. Me këtë veprim ju keni rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 19.17 të Rregullores për Prokurim Publik nr.001/2022, ku përcaktohet qartë “Projekti Ekzekutues është një dizajn grafik i të gjitha proceseve administrative dhe inxhinierike të punimeve të kërkuara siç është përshkruar në Specifikat Teknike dhe prandaj, parashtrohet, në raste të veçanta, punime arkitektonike, strukturore të punëve që do të ekzekutohen.

Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e Projektit Ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t’i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit.

Gjithashtu keni rënë në kundërshtim me LPP nr.28 Paragrafi 10: Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit.”

Pra në këtë rast ju nuk e keni respektuar dispozitën e lartcekur, pasi që keni inicuar aktivitetin e prokurimit, pa ekzistuar një projekt ekzekutues.

Ju informojmë se projektet hartohen me qëllim që të mos ketë nevojë për ritenderim dhe punë shtesë. Kjo jo vetëm që ka kosto shtesë financiare për komunat, po shkakton edhe humbje të kohës me shtim të procedurave.

1. Menaxheri i projektit të jetë i certifikuar për menaxhim të projekteve, dhe të ketë menaxhuar 3 projekte nga lëmia kërkuar.

Kërkesa që menaxheri i projektit të jetë i certifikuar për menaxhim të projekteve dhe të ketë menaxhuar 3 projekte nga lëmia kërkuar.

Vlersojmë se është e pa nevojshme dhe e pa justifikuar, është kriter i (Diskriminues), që e kufizon konkurrencën dhe kërkojmë që ky kriter të largohet nga dosja e tenderit, sepse me këtë kërkesë po tentohet të favorizohen kompani të caktuara e cila do ta ofronte një inxhinier të tillë.

2. Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i hidroteknikës i certifikuar për testim të

tubacioneve sipas standardit EN805- W400 .

Ju njoftojme se çertifikata EN805- W400 per kete aktivitet te prokurimit eshte e pa nevojshme dhe diskriminuese si dhe eshte hera pare ne ksi aktivitete vendosja e ketij kriteri duke eliminuar konkurencen .

Ju informojm se çertifikata EN805- W400 eshte per testim te gypave e ujesjellesit per uje te pijes ne shtypje, dhe rrjedhimisht kjo kërkesë nuk përkon me natyrën dhe qëllimin e punimeve në këtë tender.

3. Një inxhinier i diplomuar i programit inxhinieri e mjedisit me se paku pese(5) vite pervojë pune pas diplomimit .

Është kërkesë e pakuptimtë ose është bërë gabim teknik sepse inxhinier i mjedisit duhet per aktivitete te prokurimit qe kan te bejn me hartim te projekteve.

Me këtë kërkesë po tentohet te favorizohet një kompani e caktuar e cila do ta ofronte një inxhinier te tillë edhe pse natyra e aktivitetit të prokurimit nuk përkon me këtë kërkesë të cilën ju e keni vendos ne FDT. Prandaj kërkojmë nga ju si autoritet ta largoni këtë kërkesë nga dosja e tenderit.

4. Se paku kater (4) perosna pergjegjes nga fusha e sigurisë dhe shendetit në punë i certifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale .

Se paku kater (4) perosna te certifikuar si instalues te rrjetit te kanalizimit

Kjo kërkesë është më të vërtetë kufizuese dhe favorizuese,sepse eshte e panevoishqe qe 4 persona te jene te certifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, por mund te jen edhe nga kompani te licensuar nga AME, prandaj për të pasur një aktivitet të mirëfilltë të prokurimit dhe me kriteret korrekte e ligjore, ju duhet të largoni këtë kërkesë sepse nëse nuk largohet një kërkesë e tillë, mundësia është shumë e madhe e dëmtimit të buxhetit sepse kompania që e plotëson këtë kërkesë normalisht që oferton me çmim më të shtrenjtë.

5. Eskavator me pjesë ngjeshëse tampon për kanale min 8 ton. (1copë) –

6. - Kamion kiper me kran me peshe bartse 4-5 ton. (1copë) - - Kamion për pastrimin e kanalizimeve (1copë)

7. - Ngarkusë me fshesë min 6ton - Gjysem Rimorkio –

8. Kamion me kran me peshë bartëse max 8ton -

9. Kamionet dobelkabin me vinç 2-4ton ,

10. - një çekan pneumatikë me shtypje min 13 bar .

Po ashtu ju njoftojmë se duke vlersuar se këto kriteret te cilat i ka percaktuar AK, në këte aktivitet jane kriteret diskriminuese duke favorizuar vetem nje kompani me mekaizem te precizuar, venja e ketij mekanizmi te kufizuar per prejkte te kanalizimit duke specifikuar pasha te caktuara ne ton te cekur, dhe mekanizem te pa nevoishem per kete projekt ku si i

tillë është kriter favorizues ku ne kemi plotësisht baze dhe argumente të dyshojmë se ky tender është përgatitur vetëm për kompani të caktuara duke eliminuar konkurrencën e shëndoshe.

Na sqaroni qfare kuptimi ka të kërkohej mekanizëm duke specifikuar pesha të precizuara të caktuara dhe të panevojshme për kanalizim si -Eskavator me pjesë ngjeshëse tampon për kanale min 8 ton. (ku fare nuk hyjnë në pun pjesa për ngjeshje sepse janë kërkuar edhe ngjeshes të kanalit për këtë projekt) ,

-Kamion kiper me kran me peshe bartëse 4-5 ton, Kamion me kran me peshe bartëse max 8ton -Kamion për pastrimin e kanalizimeve

Jane kërkesë e pa nevojshme si dhe kufizuese për operatorët ekonomik, prandaj duhet të heqet-largohet kërkesa që kamioni të jetë me kran dhe duhet të heqet pesha bartëse sepse nuk kanë ndonjë efekt-ndikim këto elemente, si dhe kamioni për parstim të kanalizimeve nuk hyn në pun fare.

-Ngarkues me fshesë min 6ton - Gjysem Rimorkio

Janë kërkesa të pa nevojshme për vetë natyrën e punimeve që do të realizohen në këtë aktivitet. Kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që këto kërkesa të largohen sepse nuk ka nevojë për një ngarkues me fshesë të tillë,aktiviteti nuk ka të bëjë me mirëmbajtje të rrugëve por me ndërtim të kanalizimit, pra kërkesa e tillë nuk përkon me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit, si dhe Gjysem Rimorkio nuk duhet sepse është kërkuar edhe Rimorkio për bartjen e bagreave.

-Kamionet dobelkabin me vinç 2-4ton ,

Me këtë kërkesë po tentohet të favorizohet një kompani e caktuar e cila do ta ofronte,

Prandaj kërkojmë nga ju si autoritet ta largoni këtë kërkesë nga dosja e tenderit

Ju si autoritet kontraktues me qëllim jeni duke kërkuar pajisje të pa nevojshme e që nuk do të përdoren pothuajse fare në këto punime, mirëpo këto kërkesa vetëm sa po i ngarkojnë operatorët ekonomik dhe po i shtyni drejt heqës dore për të konkurruar në këtë aktivitet të prokurimit, prandaj edhe për këto kërkesa të pa nevojshme në kërkojmë nga ju që ti largoni në tërësi.

-Një çekan pneumatikë me shtypje min 13 bar .

(për këto kërkesa janë të pa arsyeshme dhe të pa ligjshme për arsye se toka ku do të punohet është e kategorisë III dhe IV dhe nuk nevojitet fare çekani duke specifikuar shtypjen min 13 bar).

Andaj kërkojmë që kriteret e mekanizmit të largohen nga dosja e tenderit.

Pra duke u bazuar në ligjin e prokurimit publik nuk lejohen të favorizohen një ofertues i shërbimeve dhe të përjashtohet të gjithë të tjerët pra të specifikohet mekanizmi në këtë mënyrë.

Kërkojmë nga ana juaj që të analizoni në tërësi dosjen e tenderit dhe të bëni ndryshimet e

nevojshme, konform kërkesave tona të cilat janë të bazuara në dispozita ligjore.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6.

Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur dhe natyrisht që mundësia e dëmtimit të buxhetit është shumë e madhe.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit”.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit, sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë, ndërsa kjo ndodh për shkak se nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Ju në këtë rast me këto kërkesa, nuk e keni pasur parasysh nenin 26.4 të Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për prokurim publik, sepse aty shkruan qartë se “Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”. Pra jo vetëm që po ju pamundësoni ofertimin operatorëve ekonomik të themeluar rishtazi në kundërshtim me nenin e lartcekur, por po ju pamundësoni ofertimin edhe OE me përvojë të madhe në këtë fushë.

Ju me kërkesat e lartcekura të cilat ia keni përshtatur një OE të caktuar po e rrezikoni dëmtimin e buxhetit të shtetit, pasi që në momentin që përshtaten kërkesat atëherë OE të cilët i plotësojnë këto kërkesa do të ofertojnë me çmim shumë më të lartë, ashtu siç ka ndodhur në shumë raste.

Duke u bazuar në të gjitha këto kërkesa diskriminuese-favorizues dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi këtij aktiviteti të prokurimit dhe qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe

burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë, rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 18.9 të RRUOPP ku shkruan qartë që “Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve.

Prandaj të gjitha kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Gjithashtu pa dashur që këtë paralajmërim ta keqkuptoni, ju njoftojmë se këtë tender me këto kërkesa dhe dëshmi të kërkuara ne e konsiderojmë tender të kurditur dhe normalisht që nëse nuk ndryshohen kërkesat do të jemi të detyruar të bëjmë denoncime edhe në organet tjera të cilat i përkasin fushës penale.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:
VENDIM

APROVOHET, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE “DIAMANTI SH.P.K

NDRYSHOHEN kërkesat, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veprohet konform nenit 53.7 të LPP-së

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*